

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Fall 10-2010

Lufta e Ftohtë dhe Detanti

Zjarrta Osmani

University for Business and Technology - UBT

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Law Commons](#)

Recommended Citation

Osmani, Zjarrta, "Lufta e Ftohtë dhe Detanti" (2010). *Theses and Dissertations*. 388.
<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/388>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.

Universiteti për Biznes dhe Teknologji



Fakulteti i Drejtësisë, Shkenca Politike dhe Diplomaci

Lufta e Ftohtë dhe Detanti
Shkalla Bachelor

Zjarrta Osmani

Djetor/2010
Prishtinë

Universiteti për Biznes dhe Teknologji



Fakulteti i Drejtësisë, Shkenca Politike dhe Diplomaci

Punim Diplome

Viti Akademik 2006/2007

Studentja: Zjarrta Osmani

Lufta e ftohtë dhe Detanti

Mentori: MA. Emrush Ujkani

Tetor/2010

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

MIRËNJOHJE

Për realizimin e këtij punimi falenderoj mentorin Emrush Ujkani i cili me këshillat dhe sugjereimet e tij të vyera ndihmoi për përfundimin me sukses të punës sime .

Mirënjohja ime i shkon dhe universitetit që bashkëpunuan për hartimin e këtij punimi ,gjithashtu falenderoj dhe kolegët që më ndihmuan.

PËRMBAJTJA

1. HYRJA	5
2. LUFTA E FTOHTË	8
2.1 Origjina e Luftës së ftohtë	9
2.2 Shkaqet e Luftës së ftohtë.....	12
3. BLOQET E KRIJUARA	13
3.1 Pakti NATO.....	13
3.2 Pakti I Varshavës.....	14
3.3 Armatimi Bërthamor.....	15
3.4 Veçoritë e përbashkëta.....	18
4. POLITIKA E DETANTIT	19
5. BLOKU I LINDJES	22
5.1 Gjermania	22
5.2 Hungaria.....	23
5.3 Çekosllovakia.....	23
6. BLOKU I PERËNDIMIT	25
6.1 Franca	25
6.2 Gjermania Perëndimore.....	26
6.3 SHBA dhe Evropa Perëndimore.....	27
6.4 Mos pajtimet brenda blloqeve.....	27
7. KINA	28
7.1 Ekuilibri polar dhe mbi polar i forcave.....	29
8. KONFERENCA PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM NE EUROPË	31
9. FUNDI I LUFTËS SË FOTHTË	32
10. LITERATURA	34

1. HYRJE

Lufta e Ftohtë, shprehja u krijua nga Walter Lippman më 1944 konsiderohet si një gjendje tensioni mes dy aleancave rivale që për pak mund të kalojnë në një luftë të hapur. Shprehja lidhet zakonisht me periudhën e rivalitetit politik, ekonomik, kulturor dhe ushtarak mes bllokut perëndimor kapitalist dhe atij lindor socialist pra në mes dy superfuqive SHBA dhe BS.¹

Detanti, si politikë e shtendosjes ndërmjet dy superfuqive botërore, SHBA-së dhe BRSS-së, dhe aleatëve të tyre, filloi me krizën e Karaibeve (1962) dhe vazhdoi, me sukseset dhe ngecjet e tij, deri në vitin 1990, kur, pas shumë ngjarjeve të mëdha të atyre ditëve, u shpall edhe zyrtarisht fundi i politikës së ftohtë.

Politika e Detantit u shfaq si reagim ndaj ashpërsimit të marrëdhënieve ndërkombëtare, pas LDB-së, ndërmjet dy blloqeve politike-ushtarake: të Paktit NATO dhe Traktatit të Varshavës, dhe si përpjekje për uljen e tensioneve ndërmjet superfuqive dhe për shmangien e luftës bërthamore.

Si teori dhe si praktikë, Politika e Detantit është e lidhur me Luftën e Ftohtë. Në këtë punim, në radhë të parë, prandaj janë trajtuar lidhjet dhe kushtëzimet ndërmjet këtyre dy koncepteve; kushtet dhe rrethanat e lindjes dhe të ekzistimit të Luftës së Ftohtë dhe të Politikës së Detantit; faktorët që ndikuan në këto politika; kuptimet dhe qëndrimet perëndimore dhe lindore ndaj Luftës së Ftohtë dhe Politikës së Detantit; mospajtimet e të dy krahëve të aleatëve (të Lindjes dhe të Perëndimit) me krerët e tyre, BRSS-në dhe SHBA-në, dhe në përpjekjet e tyre për t'u pavarësuar nga dy superfuqitë.

Vëmendje e veçantë, në këtë punim, i është kushtuar armatimit bërthamor dhe rolit të tij, si faktorë dominant, që përcaktoi, në fillim, përmasat e acarimit dhe të ashpërsimit të armiqtësive ndërmjet dy botëve: Lindjes dhe Perëndimit, dhe, më vonë, përcaktoi

¹ Heywood, Andrew, "Politics", Macmillan Foundations: 1997

Punim Diplome

shkallën e uljes së tensioneve dhe zbuljes së klimës politike në marrëdhëniet ndërmjet tyre, që ishte thelbi i Politikës së Detantit.

Faktorë përcaktues në Politikën e Detantit ishin, në masë të madhe, edhe mospajtimet brenda blloqeve . Në bllokun e Lindjes : në Gjermaninë Lindore, në Hungari , në Çekosllovakia dhe, në fund të viteve '80, edhe në vete BS-në, mospajtimet me ideologjinë dhe me diktaturën komuniste, u manifestuan në formë të revoltave, të demonstratave dhe të kryengritjeve gjithëpopullore, që, përveç në BS-së, u shtypen pa mëshirë nga ushtarët dhe tanket e Ushtrisë së Kuqe, ndërsa në Bllokun e Perëndimit; në Francë , në Gjermaninë Perëndimore, etj. mospajtimet me SHBA-në, u manifestuan ne formë të politikës së tyre të hapjes kah Lindja.

Për trajtimin e Politikës së Detantit, që është temë e këtij punimi, janë shfrytëzuar burimet teorike, dhe tekstet, që janë dhënë si literaturë në fund të këtij punimi dhe janë përdorur metoda e analizës, sintezës, krahasimit, tipizimit dhe e përgjithësimit.

1.1. POLITIKA E DETANTIT

Politika e Detanti, si teori por edhe si praktikë, është aq e lidhur me Luftën e Ftohtë, saqë, e ndarë prej saj dhe pa trajtimin e Luftës së Ftohtë, as mund të mendohet as mund të kuptohet. Lufta e Ftohtë , madje, i ka paraprirë kohësisht Politikës së Detantit dhe ka çuar domosdoshmërisht në këtë të fundit. Për këtë arsye, në fillimin duhet të trajtohet Lufta Lufta e Ftohtë , për të arritur te Politika e Detantit.

2. LUFTA E FTOHTË

2.1 Origjina e Luftës së ftohtë

SHBA dhe BRSS luftuan si aleate në Luftën e Dytë Botërore por nuk mendohej që dhe pas luftës do të kenë marrëdhënie miqësore. BRSS gjatë luftës së dytë botërore marrëdhëniet me SHBA-në i kishte pothuajse “miqësore” për një shkak, vetëm që kishin një armik të përbashkët Gjermaninë Naziste.²

Mosbesimi ndërmjet dy fuqive vazhdoi dhe pas luftës, ky mosbesim filloi në përmasa të mëdha gjerë sa përfunduan duke nisur një luftë të ftohtë e cila karakterizohet me tension, garë në armatim, dhe me konflikt.

Pra Lufta e Ftohtë filloi pas përfundimit të LDB-së, pas së cilës në Evropë dhe në botë ndërroi konfiguracioni dhe raporti i forcave: SHBA-ja doli si supërfuqi me bombë atomike; Franca humbi statusin e fuqisë së madhe ; Gjermania, Italia dhe Japonia e kishin humbur luftën dhe krejtësisht ishin defaktorizuar, Britania e Madhe ishte kreatore kryesore e marrëdhënieve politike ndërkombetare vetëm në dhjetëvjeçarin e parë të pasluftës; BS-ja, si fituese e luftës, arriti të renditet në ranglistën e fuqive të mëdha të botës dhe, si pasojë, pa vullnetin dhe pa bashkëpunimin e tij nuk mund të zgjidhej asnjë çështje evropiane as botërore.

Në kushte dhe në rrethana të reja, pas LDB-së, SHBA-ja dhe BS-ja, pra, u shnëdrruan në dy supërfuqi me ndikim vendimtar në Evropë dhe në gjithë botën . Ato, në raportet politike ndërkombëtare dhe në raportet ndërmjet tyre, i kishin dy mundësi që, në vija të përgjithshme, e përjashtonin njëra-tjetrën; ose do të bashkëpunonin për mirëqenien e përbashkët të tyre dhe të aleatëve ose do të konfrontoheshin me njëra-tjetrën. Rrugë të mesme nuk kishin.

Politikën e Luftës së Ftohtë , por edhe Politikën e Detantit e diktuan fuqitë e mëdha,SHBA-të dhe BS-ja, të cilat, bashkë me aleatët e tyre, kishin kuptime të

² <http://www.bbc.co.uk/history/worldwars/coldwar/>

ndryshme për ato politika: në Perëndim, ato kuptoheshin si konflikt ndërmjet fuqive të mëdha që zhvillonin politikë globale, ndërsa në Lindje, Lufta e Ftohtë dhe Politika e Detantit kuptoheshin si shprehje e luftës klasore në planin ndërkombëtar. Në të dyja rastet Lufta e Ftohtë ishte formë e zbatimit të dhunës, jo vetëm në kuptimin fizik, por edhe psikologjik, ekonomik, politik dhe shoqëror.

Për fillimin e Luftës së Ftohtë janë dhënë shumë mendime se ku filloi apo kur filloi, disa do të thonin që ka filluar në Europën Lindore, të tjerët argumentojnë që filloi në Gjermani ose afër lindjes, po ashtu disa të tjerë janë të mendimit që ngjarjet që çuan te konflikti janë nga lindja e largët. Periudha e luftës së ftohtë zakonisht gjykohet se ka filluar më 1947 me vendosjen e ashtuquajturës “Doktrina Truman” megjithëse disa e shohin qysh në konferencën e Postdamit në vitin 1945 ose bile me ndërhyrjen e perëndimoreve kundër bolshevikëve gjatë luftës civile ruse të viteve 1918-21³.

Poashtu debate të shumta janë bërë edhe për fajtorin apo nxitësin e Luftës së Ftohtë, debate të pafundme u bënë dhe për shkaqet e kësaj lufte. “Shpjegimi tradicional e hedh fajin menjëherë në derën e BRSS-së”- sipas tij kapja nga sovjetikët e Evropës Lindore është shprehje e synimeve të kaherëshme imperialiste ruse, nxit nga doktrina marksiste –leniniste e përpjekjes klasore . Nga kjo pikëpamje problem ishte te ekspansioni komunist dhe politika amerikane prej Trumanit e këndeje u përqëndrua në përmbytjen e tij, fillimisht në rindërtimin ekonomik të Evropës përmes planit Marshall (1946) dhe madje përmes krijimit të një aleance ushtarake në formën e Aleancës së Atlantikut Verior.⁴

Filimin formal të Luftës së Ftohtë e shënonte thirrja e Cërcillit, me 1946, për krijimin e Aleancës antikomuniste . Ai përdori për herë të parë edhe shprehjen “Perdja e

³ Heywood, Andrew, “Politics”, Macmillan Foundations: 1997

⁴ Heywood, Andrew, “Politics”, Macmillan Foundations: 1997

Hekurt”, duke akuzuar Stalinin për politikën e tij ekspansioniste të pasluftës, me të cilën e kishte vendosur “perden e hekurt” në Evropë, që nga Baltiku deri në Adriatik.⁵

Lufta e Ftohtë, pra është një situatë apo një gjendje tendosje ndërmjet dy superfuqive të mëdha botërore, me sisteme të ndryshme shoqërore dhe politike, SHBA-ve dhe BS-së, dhe aleatëve të tyre . Ajo është një situatë –gjendje konflikti midis forcave të ndryshme shoqërore që luftojnë për ndërrimin e sistemit ekzistues shoqëror, ekonomik dhe politik të një vendi dhe të forcave që duan ta mbrojnë atë sistem.

Megjithatë dy superfuqitë pas LDB-së, SHBA dhe BS-ja, nuk kishin luftuar drejtpërdrejt kundër njëra tjetrës, ato e mbanin për armik potencial njëra-tjetrën. Synimet tradicionale të Rusisë Cariste për depërtimin e saj në ujërat e nxehta të Oqeanit të Qetë, i rrezikonin interesat pacifiste të SHBA-ve, por jo vetëm kaq. Pas revolucionit të Tetorit , SHBA-të do të ballafaqohen, jo vetëm me shtetin proletar rus, por edhe me idelogjinë komuniste.

Në zhvillimet në, Rusi rolin primar e kishte faktori ideologjik, që dallohej vështirë ose nuk dallohej fare nga interesi shtetëror. Pas LDB-së, si vendi më i fuqishëm dhe më i fortë socialist, BS-ja mori për sipër ruajtjen e rendit shoqëror socialist, por edhe të socializmit si proces botëror në përgjithësi. Ky fakt e iritoi SHBA-në, e cila e akuzonte BRSS-në për “eksportimin e revolucionit” në botë . Në Perëndim socializmi u identifikua, kështu, me BRSS-në, revolucioni u identifikua me interesin shtetëror të tij, ndërsa partitë komuniste të Perëndimit u shpallën “kolonë e pestë sovjetike”.

Rrjedhimisht, Lufta e Ftohtë mori hov pikërisht duke e qitur në plan të parë faktorin ideologjik.

Interesat ideologjike të proletariatit, Stalini ia nënshtroi politikës dhe strategjisë shtetërore sovjetike, ndërsa ideologjinë komuniste e shndërroi në instrument të kësaj

⁵ Radovan, Vukadinoviq: “Marrëdhëniet Ndërkombetare nga Lufta e Ftohtë deri te rendi global”, Prishtinë: 2007 fq 391.

politike dhe e përdori për interesin e politikës së shtetit të vet. Ai shërbehej me ideologjinë komuniste për ta shndërruar BS-në në supërfuqi, ndërsa internacionalizmin proletar, Stalini e kuptoi si detyrë për t'i ndihmuar BS-së në realizimin e qëllimeve të veta taktike dhe strategjike .

Programi Marshall, nga ana tjetër, në industrializimin e shpejtë të vendeve aleate të SHBA-së, synonte të luftonte shpërthimet revolucionare, të pengonte partitë komuniste të merrnin pushtetin dhe që vendet perëndimore të aftësoheshin për kundërvenie ndaj kundërshtarëve të tyre- vendeve socialiste . NATO-ja duhet t'i ruante interesat perëndimore globale strategjike në Evropë. SHBA-ja u bë mbrojtëse supreme e tyre dhe hyri në raporte të drejtpërdrejta me BS-në, që ishte shteti më i fortë socialist në botë. Marrëdhëniet politike ndërkombëtare, tani, fillojnë të zhvillohen në bazë të ekuilibrit bipolar të dy blloqeve ushtarake të shteteve me regjime antagonistë shoqërore politike .⁶

⁶ Hoti , Mr.Ukshin. “Lufta e Ftohtë dhe Detanti” Prishtinë: 1976 fq.18, 19

2.2 SHKAQET LUFTËS SË FTOHTË

Me përfundimin e Luftës së Dytë botërore në vitin 1945, filloi pra Lufta e Ftohtë. Lufta e Dytë Botërore la pasoja të mëdha e këto në njëfarë mënyre u bënë shkaktaret e Luftës së Ftohtë. Shkaqet e Luftës më së lehti I identifikojmë gjatë kohës të rindërtimit të Evropës pas LDB-së. Dallimet ideologjike midis BS- së dhe SHBA-së, sistemet e ndryshme ekonomike në mes BS-së dhe SHBA-së, tensionet e larta së bashku me kërcnimet për luftë bërthamore ishin shkaqet që I çuan supërfuqitë drejtë Luftës së Ftohtë.

Një tjetër shkak I Luftës së Ftohtë, ishte dhe kontrolli që ushtronte BS-ja mbi Evropën Lindore, BS-ja kishte filluar të përhapte ideologjinë e saj komunizmin në këtë pjesë të Evropës. SHBA e alarmuar krijoi planin Marshall, ky plan kishte për qëllim të ndihmoj Evropën në rindërtimin e ekonomisë së saj . Me anë të këtij palni SHBA kishte qëllim po ashtu të përhapte ideologjinë e saj pra demokracinë dhe të mos lejonte shpërhapjen e komunizmit në Evropë. Në anën tjetër, BS-ja poashtu formoi një federate ekonomike të quajtur Comecon, që ishte veçse një tregti e kufizuar brenda BS-së . Këto masa të ndërmarra për të izoluar armikun dhe për të ngritur barriera ekonomike ndihmuan në provokimin e Luftës së Ftohtë .

Një nga çështjet kryesore që tensionoi marrëdhëniet mes BS-së dhe SHBA-së ishte kërcenimi I luftës bërthamore . SHBA kishte ndërtuar bombën atomike dhe bomba e parë atomike shpërtheu në Japoni . Kjo ngjarje bëri që SHBA të ishte lider i padiskutueshëm në ndërtimin e armëve bërthamore , për më tepër duke supozuar që vetëm SHBA kishte një pushtet të tillë çoi në besimin se zgjerimi i BS-së në Evropë mund të kontrollohej lehtë .Kjo ngjarje ishte njëra nga shkaqet më të mëdha të Luftës së Ftohtë .

Lufta e Ftohtë u shkaktua nga shumë faktorë si dallimet ideologjike, barrierat ekonomike, aleancat politike e ushtarake dhe armët bërthamore që kontribuan më së shumti në krijimin e Luftës së Ftohtë.

3. KRIJIMI I DY PAKTEVE USHTARAKE

3.1 Krijimi i paktit NATO

Më 1948 shpërtheu bomba e parë atomike ruse. Për nënshkruesit e Paktit të Brukselit, kjo gjë donte të thoshte se ekuilibri të cilin ishin përpjekur ta vendosnin në Evropë, tashmë sapo ishte prishur. Që nga ky moment atyre iu duhej të ndërtonin një aparat ushtarak pa dyshim shumë më të gjerë se gjitha mundësit e tyre reale.⁷

Më 4 Prill 1949 u nënshkrua Pakti I Atlantikut në Uashington. Qëllim kryesor i nënshkrimit të këtij pakti ishte ndihma reciproke në rast agresioni në Evropë dhe në Amerikën Veriore. Pakti I Atlantikut gjeti shprehjen e tij në krijimin e një Organizate të Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) të ngarkuar në krijimin e një force ushtarake të përbashkët nën një komandë po të përbashkët.⁸

Me krijimin e paktit NATO në vitin 1949, u vunë bazat politike, ekonomike, dhe ushtarake të grupimeve të shteteve kapitaliste. Si rezultat i politikës globale të SHBA-ve u formuan paktet ANZUS(1951), SEATO (1954), dhe CENTO (1955).

Me lidhjen e këtyre pakteve me paktin NATO jetësohet ideja e Çërcillit për krijimin e qarkut rreth rajonit që kontrollohej nga BS-ja. Por duhet thënë se krijimi i një vargu paktesh ushtarake nga SHBA-ja , nuk kishte për qëllim vetëm rrethimin sovjetik, por edhe ruajtjen dhe mbrojtjen e status quo –së , në vendet e sferës së interesit të Perëndimit , që të siguroheshin prej shpërthimeve të mundshme revolucionare .

Pra, paktet ushtarake i siguronin shtetet kapitaliste, jo vetëm nga jashtë, nga ekspansioni sovjetik ose nga eksportimi rus i revolucionit dhe socializmit, por edhe nga brenda, nga shpërthimet e mundshme të brendshme revolucionare.

⁷ Grimberg, Karl. "Historia Boterore dhe Qytetrimi" vëllimi 12 "Uegen" fq 185

⁸ Grimberg, Karl. "Historia Boterore dhe Qytetrimi" vëllimi 12 "Uegen"

3.2 Krijimi i Paktit të Varshavës

Lëvizjet antikomuniste, BS-ja i shikoi me frikë, ajo arriti në përfundim se duhet të ndërmerre diçka kundër këtyre lëvizjeve antikomuniste të bëra nga blloku perëndimor kështu BS-ja, me vendet në sferën e ndikimit të saj të interesit, lidhi kontrata për miqësi, bashkëpunim dhe ndihmë reciproke : më 1949 themelohet Këshilli për Ndihmë Reciproke Ekonomike (SEV), ndërsa më 1955 formohet Blloku Ushtarako-Politik-Traktati i Varshavës.

Qëllimi i këtyre ndërmarrjeve ishte pengimi i zhvillimit të ngjarjeve në Perëndim, pengimi i armatimit të sërishëm të Gjermanisë Perëndimore dhe frenimi i ndikimit të SHBA-së në Evropë.

Pakti i Varshavës përfshinte të gjitha vendet komuniste në Evropë si, BS, Bullgaria, Hungaria, Polonia, Rumania, Çekosllovakia, Shqipëria dhe Gjermania Lindore. Por rol dominant kishte BS-ja, vendimet merreshin në Moskë. Anëtarët e këtij pakti nuk lejoheshin të merrnin pjesë në ndonjë aleancë tjetër, por ky pakt siguroi anëtarët e saj me ndihmë të menjëherëshme duke përfshir dhe përdorimin e forcës në rast të një agresioni të armatosur.

Ky pakt u krijua si kundërpërgjigje ndaj paktit NATO . Megjithatë këto dy pakte asnjëherë nuk bënë luftë direkte me njëra-tjetrën. Ato luftuan me anë të politikave dhe strategjive që implementoheshin tek aleatët e tyre.

Me mbarimin e Luftës së Ftohtë në fund të 80-ve Pakti i Varshavës u bë i panevojshëm dhe i padëshirueshëm dhe shumë shtete që ishin anëtare të këtij pakti iu bashkuan NATO-s.

3.3 Armatimi bërthamor

Armatimi bërthamor u bë, kështu, instrument i politikës së dhunës, por nga ana tjetër, ai ndikoi edhe në evitimin e një lufte ndërmjet superfuqive, me përmasa botërore dhe me pasoja të paparashikushme. Ai ndikoi, gjithashtu, edhe në ndërrimin e konceptit të luftës së të dy superfuqive, duke vënë në qendër të tij faktorin tekniko-teknologjik.

Açeson dhe Dallas krijuan teorinë e politikës së negociatave “nga pozita e forcës”. Sipas tyre, BS është iniciator i të gjitha krizave politike në botë. Qeveria sovjetike është realiste në nivel të lartë. Ajo mund t’u përshtatet fakteve kur ato ekzistojnë. Ne duhet të krijojmë forcë. Me metoda të dhunës mund të luftojmë kundër “ekspansionizmit sovjetik”, në vend të dobësisë. Nga situatat e forta lindin marrëveshjet. Kudo që ekzistojnë, pozitat e dobësisë, ato janë ftesë tërheqëse për qeverinë sovjetike, për të gjuajtur në ujërat e trubullta. Ne do të punojmë që t’i ndërrojmë situatat e dobësive, që të mos krijohen kushte për gjuajtjen e peshqve.⁹

Në frymë të kësaj doktrine, SHBA-të krijuan një varg bazash ushtarake në botë, për ta rrethuar botën socialiste. Kremli e pranoi përparësinë amerikane në regjionet që nuk ishin nën ndikimin e BS-së, por Dallas nuk u ndal me kaq. Ai shkoi edhe më tutje : “Duhet shfrytëzuar përparësinë e krijuar për dezintegrimin e sistemit socialist dhe për çlirimin gradual të vendeve socialiste prej diktaturës komuniste të Moskës, që është garancioni i vetëm i regjimeve komuniste. Një presion i fortë ekonomik, politik dhe psikologjik amerikan në vendet socialiste, do të çonte në çlirimin paqësor të satelitëve sovjetik dhe kthimin e armikut prapa”¹⁰ thoshte ai .

Pas eksperimentimit me bombën hidrogjenike, në SHBA flitej për strategjinë e re politike ushtarake – “Tmerrimin e armikut me armë bërthamore” dhe me “hakmarrja

⁹ Hoti , Mr.Ukshin. “Lufta e Ftohte dhe Detanti”, Prishtinë: 1976 fq 23

¹⁰ Hoti , Mr.Ukshin.“Lufta e Ftohte dhe Detanti”, Prishtinë: 1976 fq 24

massive “, si mbështetje e fundit në zhvillimin e luftave lokale. Kjo strategji i kontribuoi ashpërsimit të mëtejshëm të politikës së Luftës së Ftohtë ¹¹(po aty, fq 24)

Por edhe ana e tjetër, BS-ja , dispononte fuqi pothuaj të njejtë, si SHBA-ja. Në vitin 1953 eksplodoi bomba e parë termonukleare sovjetike, që i dha goditje të rëndë “Teorisë së luftës nukleare të kufizuar”. Në këtë situatë, Kisinxheri rekomandoi shtimin e forcave të armatosura klasike të SHBA-ve, që do të duhej të ishin aq të fuqishme, sa mbrojtja nukleare do të ishte mjeti i fundit. Me raketat interkontinentale si mjet i transportit të shpejtë të armëve nukleare në largësi të mëdha – fuqizohet prapë faktori tekniko-teknologjik. Kjo ishte strategjia e “ Frikësimit me sulmin e parë”.

Pas prodhimit të raketave të ngjajshme, po aq efektive, edhe në BS-në, Tejlori doli me një formulë të re. Sipas tij, “ SHBA-të duhej të pranonin çdo provokim të BS-së, dhe t’i jepnin përgjigje që mund të bazohej në armët nukleare “. ¹² Presidenti amerikan Kenedi e pranoi këtë formulë, por ai e plotësoi me një gjysmë fjali tjetër, se.....përgjigjja duhej të ishte elastike, e vendosur dhe duhej t’i përshtatej çdo tipi të luftës ¹³.

Duhet thënë se teoritë ushtarake strategjike në SHBA vareshin kryesisht prej kualitetit dhe kuantitetit të armëve nukleare. Sa ishte superior ky armatim, aq radikale dhe agresive ishin edhe teoritë amerikane. Përveq kësaj, teoritë amerikane mbështeteshin edhe në disponimin e kapaciteteve më të mëdha industriale të SHBA-ve, në krahasim me BS-në, për zhvillimin e luftës eventuale.

BS-ja, në krahasim me SHBA-në, ishte superior me njerëz dhe me forcën tokësore të saj në Evropë dhe në Azi, por aspiratat sovjetike për nivelizimin e forcave të tyre të armëve bërthamore me ato amerikane ishin të mëdha . Për këtë qëllim kërkoheshin koncentrimet të mëdha të mjeteve materiale-financiare, për zhvillimin e industrisë së

¹² Hoti , Mr.Ukshin. “Lufta e Ftohtë dhe Detanti” Prishtinë: 1976 fq 26

¹³ Hoti , Mr.Ukshin. “Lufta e Ftohtë dhe Detanti” Prishtinë: 1976 fq 26

rëndë ushtarake, me angazhimin dhe me përpjekje të mëdha edhe të aleatëve të tij lindor, që shkonte në dëm të standardit jetësor të popujve të tyre.

Si pasojë e zhvillimeve të këtilla, në BS u paraqitën dy koncepte të kundërta. Sipas njërit, që I takonte vijës së ashpër politike, duhej të vazhdohej me zhvillimin e industrisë së rëndë ushtarake, që duhej të garantonte ndjekjen e hapave amerikanë në armatimin bërthamor. Ky koncept, përvec në nivelizimin e armëve bërthamore me SHBA-në, do të faktroizonte ushtarakët sovjetikë në marrjen e vendimeve politike.

Sipas konceptit tjetër që e përfaqësonte vijën e moderuar të politikës sovjetike, BS-së i duhej një orientim i ri kah industria e lehtë, që do të ndikonte në ngritjen e standardit jetësor të qytetarëve . Hrushcovi aplikoi formulën e kompromisit për pajtimin e dy koncepteve. Sipas tij, “ Elementi i befasimit në luftën eventuale duhet të plotësohet me nevojën e krijimit të rrjetave të gjera të sinjalizimit adekuat dhe me kohë. Lufta e ardhshme do të filloi papritmas dhe përparësitë fillestare operative, taktikedhe strategjike do të kenë rëndësi vendimtare për zhvillimin e mëtejshëm dhe për përfundimin e luftës”¹⁴.

Investimet kolosale, gati 50% i të ardhurave kombëtare, në armatim në përgjithësi dhe, sidomos, armët nukleare, e tejngarkuan ekonominë e BS-së dhe ekonomitë e aleatëve të tij. Si pasojë, BS-ja u detyrua t’l kthehej teorisë së KOEKZISTENCES (ekzistimi paralel i vendeve, me rend të ndryshëm shoqëror politik) paqësor. Politikës së koekzistencës paqësore i dhanë kuptim dhe e fuqizuan, përveç armët bërthamore, edhe ndërvarësia ekonomike ndërmjet shetëve dhe rritja e forcave paqësore në botë. Politika e koekzistencës paqësore, me një bazë të gjerë, kështu, u shndërrua në Politikë të Detantit, e cila imponoi një të re, atmosferë më të butë dhe me ton më miqësorë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ajo krijoi mundësi më të mëdha për bashkëpunim ndërmjet SHBA-së dhe BS-së, por edhe ndërmjet aleatëve të tyre.

¹⁴ Hoti , Mr.Ukshin : Lufta e Ftohte dhe Detanti Prishtine fq 27

¹⁴ Hoti , Mr.Ukshin : Lufta e Ftohte dhe Detanti Prishtine fq 29

3.4 Veçoritë e përbashkëta

Të dy blloqet ushtarake: Pakti NATO dhe Traktati i Varshavës, me gjithë dallimet e mëdha ndërmjet tyre, i kanë edhe disa veçori të përbashkëta:

1. Tërësia territoriale e secilit bllok,
2. Pozita dominuese në bllok e SHBA-së përkatësisht e BS-së,
3. Armët bërthamore ishin mbështetje e ekuilibrit bipolar të fuqive.

4. POLITIKA E DETANTIT

Në SHBA, Lufta e Ftohë, në fillim, mundësoi konsensusin e brendshëm të shoqërisë amerikane, por në prespektivë dhe në forcën ekonomike, ajo çoi në thyrjen e konsensusit nacional. Në planin e brendshëm Lufta e Ftohtë shkaktoi polarizimin e forcave shoqërore dhe thellimin e kundërthënieve ekzistuese në shoqërinë amerikane, të cilat u manifestuan në konfliktin midis pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv. Trajtimi amerikan i Politikës së Detantit, prandaj, është i kushtëzuar nga ruajtja e status quo-së politike në planin e brendshëm dhe në planin ndërkombëtar. Përveq kësaj, gara në armatim arriti në pikën përtej së cilës nuk mund të shkohej.

Këto arsye i çuan SHBA-të dhe BS-në në fillimin e negociatave rreth çarmatimit, për të dëshmuar para opinionit botëror dhe para opinionëve të brendshme, se superfuqitë ishin paqëruajtëse. Kështu u vazhduan hapat e parë për çarmatimin, që ishin bërë qysh në vitin 1941, nga Çërcilli dhe Rusvelti, në Kartën e Atlantikut.

Armët bërthamore kanë pasur një ndikim të dyfishtë, negativ dhe pozitiv, në marrëdhëniet politike ndërkombëtare. Fillimisht, kur vetëm njëra palë dispononte me armët bërthamore, ato kanë mundur të jenë instrument i politikës së frikës, kërcënimit e të dhunës dhe, për një kohë të caktuar, kanë ndikuar në acarimin dhe në ashpërsimin e marrëdhënieve politike ndërkombëtare, por më vonë, me kuptimin e fuqisë shkatërruese dhe rreziqeve nga përdorimi i tyre, lufta u bë e pakuptimtë, ndërsa armët bërthamore ndikuan në kërkimin e zgjidhjeve paqësore të kontesteve ndërkombëtare si dhe në drejtim të krijimit të politikës së DETANTIT ose të zbutjes së atmosferës politike. Në kushtet e detantit, marrëdhëniet sovjeta-amerikane mbështeteshin në domosdoshmërinë e pengimit të shpërthimit të luftës bërthamore; në shfrytëzimin e forcave, resurseve dhe të mjeteve të secilës palë dhe në dobinë e përbashkët nga bashkëpunimi tregtar, teknik dhe kulturor.

Politika e zbutjes së atmosferës ndërkombëtare ose e uljes së tensionit, e shprehur me fjalën franceze DETANT (détente), është e lidhur me Krizën e Karaibeve (Kubë, tetor

1962), në të cilën arrihet kulmi i ashpërsimit të marrëdhënive SHBA-BRSS, dhe filloi pas vendimit të qeverisë sovjetike për tërheqjen nga Kuba të armatimit raketor me mbushje bërthamore . Megjithëkëtë, as pas vitit 1962 nuk mund të flitet për Detantin në kuptimin e plotë të kësaj fjale, sepse politika e SHBA-ve dhe e BS-së ishte kombinim marrëveshjesh dhe garash selektive, në disa regjione, dhe ashpërsim i raporteve dhe konfortimeve, në regjione të tjera.

Politika e Detantit është imponuar, në radhë të parë dhe para se gjithash, nga rreziku i shpërthimit të luftës bërthamore , që, në rast të një konflikti eventual, do të kishte pasojë shkatërruese, jo vetëm për të dy superfuqitë, por edhe për gjininë njerzore, në përgjithësi , dhe për gjithë rruzullin tokësor. Për të pasur parasysh përmasat e shkatërrimit në një konflikt të mundshëm bërthamor, majfton të kihet parasysh deklarata e Hrushcovit, e vitit 1964 : “BS disponon bombën hidregjenike prej 100 megatonësh, pasojat e së cilës, sikur të hudhej në Paris, do të ndiheshin në Moskë”¹⁵.Pra bomba hidrogjenike ishte krejtësisht e papërdorshme për shkak të forcës së saj aq të madhe shkatërruese.

Shtendosja, një term tjetër që mund të përdoret në vend të Detanitit , ndikoi edhe në shkarkimin e ekonomive të fuqive të mëdha, gjë që u prit mirë nga dy superfuqitë, por sidomos, nga qytetarët e tyre, mirëqenia e të cilëve ishte cënuar.

Rezervat e mëdha të armëve bërthamore dhe rreziku nga përdorimi i tyre ndikuan në ndryshimin e raporteve ndërmjet politikës dhe konflikteve të armatosura. Derisa para armatimit bërthamor, lufta ishte mjet në shërbim të jetësimit të politikës, tani, në epokën e armatimit bërthamor, nuk mund të lejohej që krizat politike të shndërroheshin në konflikte të armatosura.

Para konfliktit të armatosur, që do të mund të përfundonte në një luftë bërthamore pa fitues në të cilën do të humbnin të dy superfuqitë dhe aleatët e tyre, parapëlqejë marrëveshja ose, të paktën, kontrollimi i tij. Marrëveshjet e para u arritën, fillimisht, në

¹⁵ Hoti , Mr.Ukshin : Lufta e Ftohte dhe Detanti Prishtine fq 29

ndalimin e eksperimenteve bërthamore në atmosferë, nën ujë dhe nën sipërfaqe të dheut, pastaj edhe në kufizimin e zgjerimit të armëve bërthamore.

Politika e uljes së tensioneve ndërmjet të dy superfuqive: SHBA-ve dhe BRSS-së përmbante në vete negociata, kompromise dhe koncesione të ndërsjella dhe ofronte mundësi të mëdha për zhvillim marrëdhëniesh bilaterale dhe multilaterale ndërmjet shteteve. Megjithatë, kjo nuk do të thoshte se ato kishin hequr dorë nga strategjitë globale as nga interesat vitale të tyre. Politika e Detantit çoi në precizimin e interesave të tyre për disa çështje dhe për disa regjione të caktuara në botë. Parimi i njohur “tërhiqe e mos e këput” shpreh më së miri Politikën e Detantit : asnjëra nga superfuqitë nuk lejonte lëshime substanciale në raport me tjetrën, por as nuk ndikonte në keqësimin e marrëdhënive të ndërsjella. Kështu u vendos dhe ruhej drejtëpeshimi ndërmjet dy superfuqive.

Detanti është gjendje ose bilanci i marrëdhënieve ndërmjet dy blloqeve politike-ushtarake. Ai është proces i marrëdhënieve dhe i uljes së tensionit, si midis bartësve kryesor të politikës bllokiste : SHBA-ve dhe BS-së, ashtu edhe midis aleatëve të tyre.

Për më tepër, Detanti është një zbutje e marrëdhënieve ndërmjet dy pakteve ushtarake, dhe njëkohësishtë, edhe liberalizim i marrëdhënieve brenda secilit prej tyre. Detanti, pra është *staus quo*-ja në marrëdhëniet ndërbllokiste, që shërben si bazë fillesatre për masa të mëtejme për uljen e tensionit.

5. BLOKU I LINDJES

5.1 Gjermania

Mospajtimet brenda bllokut socialist filluan në Republikën Demokratike të Gjermanisë, me grevën e punëtoreve në Lajpcig dhe në Berlinin Perëndimor, me 16 qershor 1953, që u shndërrua në kryengritjen e parë kundër diktaturës komuniste. Ajo u shtyp nga ushtria dhe tanket ruse, që lanë të vranë 50 gjermanë, qindra të tjerë të plagosur dhe mbi 1500 protestues u dënuan me burg, është interesant të përmendet edhe fakti se në këto zhvillime u pushkatuan edhe 50 ushtarë rus, që nuk kishin pranuar të shtinin mbi protestuesit¹⁶. Mospajtimet vazhduan dhe ndër vite .

Gjermania Lindore ishte e kontrolluar nga BS-ja ndërsa ajo Perëndimore nga SHBA-ja. Gjermania Perëndimore ishte më e begatë se ajo Lindore . Kjo sepse Stalini i kishte ndaluar Gjermanisë Lindore ti bashkohej planit Marshall ndërsa Gjermania Perëndimore kishte përfituar nga ky plan . Shihej qartë dallimi mes jetesës në Lindje dhe asaj në Perëndim . Gjermania lindore ishte më e varfër, kështu shumë gjerman lindor u nisën për në Gjermaninë Perëndimore për të pasur një jetë më të mirë . Qeveria e Gjermanisë Lindore provoi të ndalte fluksin e njerzëve duke përforcuar kufijtë. Por numër i madh i gjermanëve lindor braktisnin vendin duke shkuar drejt Gjermanisë Perëndimore duke lënë kështu sistemin komunist për t'iu bashkuar atij demokratik. Kjo i shtyri autoritetet të bëjnë dicka për ta ndaluar këtë lëvizje të lindorve drejt perëndimit . Në orët e hershme të Gushtit 1961 Berlini Perëndimor ishte i rrethuar me një mur 4 metra të lartë dhe 111 kilometra të gjatë, përgjatë tij ishin vendosur ushtarë, ky mur ishte e pamundur të kalohej.

Autoritet gjermane u munduan të shpjegojnë ndërtimin e murit duke thënë se Berlini Perëndimor ishte bërë qendër e spiunazhit dhe muri ishte për të mbajtur larg spiunët . Edhe pse ishte e pamundur të kalohej ky mur gjermanët lindor sërish provuan të kalonin në Berlinin Perëndimor , shumë njerëz u qëlluan dhe u vranë në pjesën lindore

¹⁶ Radovan, Vukadinoviq: "Marredheniet Nderkombetare nga Lufta e Ftohte deri te rendi globa", Prishtine fq 396

të murit . Ky mur famëkeq ishte simbol i ndarjes së lindjes dhe perëndimit, ishte simbol i Luftës së Ftohtë vërehej se Berlina ishte qendër e Luftës së Ftohtë.

5.2 Hungaria

Pas RDGJ-së, pakënaqesitë kundër pushtetit komunist shpërthyen në Hungari. Ato filluan me demonstratat e studentëve në Budapest dhe, pas përkrahjes së tyre nga policia dhe ushtria hungareze, ato u shndërruan në kryengritje të përgjithëshme. Ata diskutuan gjashtë pikët e tyre të cilat përfshinin liri personale, më shumë ushqim, zhvendosjen e policisë sekrete dhe kontrollit rus .

Si rezultat, u shpall Qeveria Demokratike me Imre Naxhin në krye, i cili premtoi demokraci, pavarësi, neutralitet dhe daljen e Hungarisë nga Traktati i Varshavës. Pas përkrahjes së Qeverisë Naxhi nga fuqitë perëndimore, Armata e Kuqe e pushtoi Hungarinë, e mori pushtetin dhe vendosi paqen e përgjakshme në gjithë vendin.¹⁷

Tanket ruse zvarriten mijëra protestues hungarez duke i frikësuar ata që protestonin ende, Naxhi u gjykua dhe u ekzekutua . Çdo përpjekje e hungarezve u shkatërrua , Kadar i cili u përkrah nga BS-ja u vu në krye.

5.3 Çekosllovakia

Pakënaqesitë dhe përpjekjet për liberalizimin e regjimit komunist, në Evropën Lindore, e arritën kulmin në Çekosllovakia, në vitin 1968. Lëvizja studentore çekoslloake kërkonte lirinë e shtypit, të drejtën e grumbullimit publik, lirinë e praktikimit të besimit fetar dhe reforma politike dhe ekonomike.

Kjo lëvizje , e njohur si Pranvera e Pragës kishte ndikim të madh edhe te regjimet e tjera të Evropës Lindore dhe ishte rrezik për sistemin komunist sovjetik. Për këtë arsye , me 20-21 gusht 1968 trupat ushtarke të Traktatit të Varshavës, duke hyrë në Pragë, pushtuan Çekosllovakinë dhe e shtypën me forcën e armeve Lëvizjen çekoslloake.¹⁸

¹⁷ Radovan, Vukadinoviq.....fq 399

¹⁸ Radovan, Vukadinoviq.....fq 406

Punim Diplome

Pas pushtimit sovjetik të Çekosllovakisë, Shqipëria , e pakënaqur me pushtimin sovjetik, është e vetmja nga anëtarët e bllokut lindor, që largohet nga Traktati i Varshavës.

6. BLOKU I PERËNDIMIT

6.1 Franca

Ndër vendet evropërisht, Franca ishte vendi i parë që i shprehte interesat e veta individuale për një pavarësi nga blloku perëndimor, me parullën e gjeneralit De Gaulle "Evropa e evropianëve". De Gaulle, në fakt, synonte kthimin e famës së dikurshme të Francës dhe "daljen e saj nga hijja e SHBA-së", në të cilën kishte rënë pas LDB-së. Ai konsideronte se Franca nuk kishte siguruar tretman të barabartë në Paktin NATO dhe kërkoi që në krye të tij të vihej "direktoriumi" prej tre anëtarësh. Kërkesa e De Gaulle nuk u përfill nga kryetari i SHBA-së, Ajzenhauer. As teoria e Kenedit për "përgjegjësinë fleksibile", nuk ishte në favor të armatimit nuklear të vendeve më të vogëla.

Nga ana tjetër, angazhimi amerikan në Indokinë, në rajonin me interes tradicional për Francën, e bindi De Gaulle se SHBA-ja nuk është partner i barabartë me Francën. Si rrjedhim, më 10 mars 1966, Franca del nga NATO-ja dhe kërkon zhvendosjen e Shtabit të NATO-s nga territori i saj. NATO kështu, transferohet nga Parisi në Bruksel. Në vitin 1968, Franca bëhet fuqi termobërthamore.

Në këto rrethana, De Gaulle u orientua kah BS-ja, me qëllim që të luante një rol të rëndësishëm në ekuilibrin mbipolar midis SHBA-së dhe BS-së. Më 1964 Franca njohu Kinën, ndërsa dy vjet më vonë ajo dhe BS-ja shkëmbyen vizita të nivelit më të lartë dhe formuan "Komisionin e Madh Sovjeto-Francez" për gjetjen e formave të bashkëpunimit afatgjatë ndërmjet tyre.

Me këto zhvillime dëshirohej të "thyhej protektorati amerikan" në Evropë, të shprehej mospajtimi i Francës me politikën amerikane ndaj Kinës dhe të dëshmohej politika e pavarur e Francës në kuadër të NATO-s, por orientimi i Francës kah BS-ja nuk zgjati shumë. Ngjarjet shpërthyesë të vitit 1968 në Francë, e shtynë De Gaulle të ndiqte një politikë më realiste në marrëdhëniet politike ndërkombëtare dhe ndaj SHBA-ve. Para

largimit të tij nga jeta politike, ai do të deklaronte se “ Amerika dhe Franca do të jenë së bashku nëse njerëzimi do të përjetojë fatëkeqësi të mëdha”.¹⁹

6.2 Gjermania Perëndimore

As Gjermania Perëndimore nuk ishte e kënaqur me hapësirën e ngushtë të saj në Perëndim dhe me izolimin e saj nga Lindja. Zhvillimi i madh ekonomik i saj kërkonte hapësirë më të madhe për politikë më të pavarur gjermane nga blloku perëndimor.

Për të krijuar këtë hapësirë, Vili Branti organizoi takimin e parë gjermano-gjerman në Erfurt, në mars 1970 . Në këtë vit, me 12 gusht, organizohet edhe takimi gjermano – sovjetik dhe , me 7 dhjetor, edhe takimi gjermano-polak . Kancelari gjermanoperëndimor, Vili Branti, shpalli Politikën Reale Lindore, me të cilën Gjermania Perëndimore e njëjtte gjendjen ekzistuese në Evropë; e pranoi pacënueshmërinë e kufijëve në Evropë; dhe mospërdorimin e forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare. Me Poloninë , Vili Branti konfirmoi pakontestueshmërinë e kufirit Oder-Nise.

Me këto veprime Gjermania nuk bëri gjë tjetër veç se pranoi realitetin ekzistues evropian dhe, kështu mundësoi një zhvillim më intensiv të Politikës së Detantit dhe mbajtjen e Konferencës për Siguri dhe Bashkepunim në Evropë.

¹⁹ Radovan, Vukadinoviq.....fq 76

6.3 SHBA dhe Evropa Perëndimore

Megjithë dëshirën dhe synimet e Evropës Perëndimore për një tërësi integrale të saj, të pavarur nga SHBA-të, duhet thënë se ajo nuk mund të sillej në mënyrë të pavarur në skenën politike botërore, sepse kapitali i saj ishte i lidhur me kapitalin amerikan .

SHBA-të dispononin burime të vetat të lëndëve të para atë energjisë, ndërsa Evropa Perëndimore varej qind për qind prej vendeve prodhuese të naftës dhe 45 deri 95 për qind varej prej lëndëve të para të vendeve të tjera .

Për këtë arsye Evropa Perëndimore nuk mund të qëndronte pa SHBA-të, jo vetëm në kushtet e konfrontimit politik të tipit të Luftës së Ftohtë, por as edhe pa angazhimin e saj konkret, ekonomik dhe politik. Hapja e tyre ndaj SHBA-ve dhe demokratizimi i marrëdhënieve ndërkombëtare politike dhe ekonomike, prandaj, është në interesin e tyre.

6.4 Mospajtimet brenda blloqeve

Secila superfuqi interesat e veta i kishte vendosur mbi aleatët e vet . Për këtë arsye lindën mospajtimet e brendshme në secilin bllok . Në Bllokun Perëndimore u krijua një ndjesi për një tërësi integrale të Evropës dhe dëshirën e saj për pengimin e depërtimit të kapitalit të madh amerikan në Evropë dhe të sjelljes të saj, si protektor, ndaj aleatëve evropianë në njerën anë dhe në anën tjetër, në Bllokun Lindor, për të njejtat arsye, lindën pakënaqitë e shtetve lindore me BS-në .

Këtu zënë fill tendencat dhe kundërthëniet e brendshme në të dy blloqet, që çuan në përpjekje për organizime të pavaruara brenda tyre, pothuajse në të njejtën kohë : Në Evropën Perëndimore nga SHBA-ja dhe në Evropën Lindore nga BS-ja .

7. KINA

Shqëtesimet e perëndimoreve për mundësinë e shtrirjes së socializmit edhe në vendet azaitike dhe afrikane, që ishte paraparë, u bënë realitet me fitorën e revolucionit kinez, i cili ishte disfatë e politikës amerikane të “ ndaljes së depërtimit komunist” dhe i rrezikoi seriozisht interesat e SHBA-ve . Këtë e dëshmonte edhe Açesoni, i cili deklaroi se “regjimet komuniste u shërbejnë interesave të Rusisë sovjetike “.

Pas përmbysjeve revolucionare në Kinë, SHBA-ja mbajti anën e Çang Kaj Shisë dhe e ndihmuan atë kundër RP të Kinës, ndërsa këtë të fundit e penguan për ta ndihmuar luftën nacionalçlirimtare të popujve indokinez dhe për t’u anëtarësuar në OKB, me arsyetime juridike të ndryshimit revolucionar , pra me dhunë, të sistemit shoqëror-politik në Kinë dhe se Kinën e përfaqësonte në OKB Çang Kaj Shi, i cili ishte tërhequr në Tajvan. Për të parë sa të qëndrueshme ishin këto arsyetime, mjafton të kihet parasysh fakti se ndryshimet në sistemin shtetëror në një shtet nuk mund të çënojnë subjektivitetin ndërkombëtar të tij.

Për më tepër, në OKB kishte shtete-anëtare, regjimet e të cilave e kishin marrë pushtetin me grushtshtet ushtarak ose me revolucion. Më vonë u propozua që të pranoheshin dy Kina, por ky do të ishte legalizimi i ndarjes së Kinës, gjë që nuk pranohej nga kjo e fundit. SHBA-të pastaj e shpallën Kinën shtet jo paqësor, ilegalitet dhe të paaftë për t’i kryer obligimet ndërkombëtare .

Lidhur me qëndrimet e ndryshme të anëtarëve të OKB-së dhe sidomos të anëtarëve të Këshillit të Sigurimit, ndaj anëtarësimit në OKB të Kinës, Nicholas thoshte se “ qëndrimi arbitrar i anëtarëve të KS-së të OKB-së dhe anëtarësimi i disa shteteve në OKB janë bërë lëndë pazarllëku ndërmjet shteteve-anëtare të KS të OKB-së”.

Çështja e përfaqësimit të Kinës në OKB, në të vërtetë , nuk ishte çështje e të drejtave juridike, por ishte çështje politike dhe dueli për pranimin e Kinës në OKB, nuk zhvillohej ndërmjet OKB-së dhe Kinës, por ndërmjet të kësaj të fundit dhe SHBA-së. Ndërkohë që

Lufta e Ftohtë zhvillohej ndërmjet SHBA-së dhe BS-së. Hija e këtij të fundit qëndronte prapa çdo krize ndërmjet SHBA –së dhe RP te Kinës.

7.1 Ekuilibri polar dhe mbi polar i forcave

Teknologjia nukleare humbi rëndësinë e faktorit gjeostrategjik të të dy superfuqive, SHBA-së, që konsiderohej “fuqi e ishujve”, dhe BS-së , që konsiderohej fuqi kontinentale . Atyre , tashmë, u përgjigjej ekuilibri dypalësh I forcave, si në Evropë ashtu edhe në Pacifik. Një fuqi e fortë evropiane (Franca , Gjermania) ose në Lindjen e Lartë (Japonia) do të ishte rrezik potencial për secilën prej tyre.

Ekuilibri i fuqive ushtarake bërthamore, përgjithësisht ishte politik jostabile ndërkombëtare. Ai, sidomos në situata krizash, imponoi një bashkëpunim të kujdesshëm të ndërsjellë ndërmjet SHBA-së dhe BS-së, të cilat përmbaheshin që të mos shkaktohej luftë me përmasa të gjera . Kur Çang Kai Shi, p.sh deklaronte se do të hyjë me forcë në Kinën kontinentale, Hrushçovi thoshte se, në atë rast, BS-ja do të mbante anën e Kinës, ndërsa SHBA-ja deklaronte se nuk përkrahnin qëllimet e Tajvanit.

Nga ana tjetër, sikur Kina të deklaronte se do ta clironte me forcë Tajvanin, dy superfuqitë do të vepronin njëllorj: BS-ja nuk do te bëzante, do të thote se nuk do ta përkrahte Kinën, ndërsa SHBA-ja, si zakonisht, do të përsëriste kërcnimet e saj ndaj Kinss. Kjo do të thotë se marrëveshjet e tyre kishin karakter mbrojtës bilateral dhe synonin ruajtjen e ekuilibrit polar të forcave.

Nga viti 1955 filloi dezintegrimi brenda blloqeve ushtarake. Mospajtimet ndërmjet shteteve perëndimore u shfaqen lidhur me krizën në Lindjen e Afërt. SHBA-ja shprehte prije për metoda më moderne të qeverisjes koloniale dhe , me metoda ekonomike hyri në kolonitë vitale të ish-metropoleve. Këto të fundit e mbanin një qëndrim me konzervator ndaj kolonive. Kështu filloi një ekuilibër në baza bipolare, në baza të

Punim Diplome

politikës së pavarur të të dy superfuqive: SHBA-së dhe BS-së , që ua diktonin politikat e tyre aleatëve të vet.

8. KONFERENCA PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM NË EVROPË

KSBE-ja është rezultat i përpjekjeve gati 30 vjeçare, që nga koha e Kartës së OKB-së për uljen e tensioneve, jo vetëm ndërmjet blloqeve ushtarake, por edhe më gjerë .

Konferenca deklaroi parimet themelore, me të cilat definoheshin normat e sjelljeve dhe të marrëdhënieve të ndërsjellta të shteteve pjesëmarrëse. Dokumentet e saj kishin përmbajtje më të gjerë se Deklarata e OKB-së. Përveç parimeve të të drejtave ndërkombëtare mbi raportet miqësore dhe bashkëpunimin ndërmjet shteteve, si : respektimi i barazisë sovrane, përmbajtja nga kërcenimi me dhunë ose me përdorimin e forcës, zgjidhja paqësore e kontesteve ndërmjet shteteve, mospërzjerja në punët e brendshme, barazia, e drejta e popujve për vetëvendosje, zbatimi i obligimeve ndërkombëtare, etj..

Dokumenti i KSBE-së përmban edhe tri parime të reja : Moscënimii i kufijëve të shteteve pjesëmarrëse në Konferencë dhe të shteteve të tjera, respektimi i integritetit territorial të shteteve dhe respektimi i të drejtave njerëzore dhe të lirive themelore të njeriut.

Vlerësimet e procesit të uljes së tensionit nga KSBE-ja ishin të ndryshme . Sipas BRSS-së, KSBE-ja i vuri kornizat e marrëdhënieve të reja ndërkombëtare, të cilat nuk i evitojnë dallimet në ideologji dhe në pikëpamje të sistemeve shoqërore-politike. Sipas SHBA-ve, kjo ishte një politikë, e cila, në esencë mundësonte mbajtjen e status quo-së.

9. FUNDI I LUFTËS SË FTOHTË

Debati lidhur me fundin e Luftës së Ftohtë është përzier me kundërthënie ideologjike po aq sa edhe debate lidhur me zanafillën e saj. Një version iu vesh Ronald Reganit përmbylljen e Luftës së Ftohtë, duke nxit një rifuqizim ushtarak të SHBA-ve në fillim të viteve 1988, BRSS u përfshi në një garë armatimesh që ekonomia e saj e brishtë nuk mund të përballonte. Kjo tezë sugjeron që perëndimi e “fitoi” Luftën e Ftohtë sepse vetëm stili amerikan liberal i demokracisë ofronte një sistem të zbatueshëm ekonomik dhe politik.²⁰

Versionet tjera kanë theksuar më shumë dobësitë e ekonomise sovjetike dhe keqpërdorimin katastrofal të procesit të reformës nga Mihail Gerbaçov. Lufta e Ftohtë dhe Politika e Detantit, për afër 30 vjet, kanë bashkëjetuar në njëra është zbutur dhe është dobësuar tjetra dhe anastjelltas, por duhet thënë se Politika e Detantit ka qëndruar gjithmonë nën hijen e Luftës së Ftohtë . Pra , e para varej dhe kushtëzohej gjithnjë e dyta .

Megjithë sukseset e konsiderueshme , por modeste, të Detantit, si politikë e zbutjes ose si ulje e tensioneve politike ndërkombëtare, të filluar, siç është thënë më lartë, pas vendimit të qeverisë sovjetike për tërheqjen nga Kuba të armatimit të saj raketor me mbushje bërthamore, Lufta e Ftohtë ndërmjet të dy superfuqive, SHBA-së e BRSS-së, dhe aleatëve të tyre, ka vazhduar deri në vitin 1990.

Përfundimit të Luftës së Ftohtë I parapriu rënia e Murit te Berlinit, simbolit të Gjermanisë së ndarë, më 9 nëntor 1989, kur ra sistemi komunist. Përfundimin e saj, qysh me 2 dhjetor 1989, e kishin shpallur simbolikisht Bushi dhe Gërbaçovi, kurse, pas bashkimit formal të Gjermanisë (3 tetor 1990), në mbledhjen e OSBE-së, më 19-21 nëntor 1990, në Paris, në të cilën morën pjesë 33 vende evropiane, SHBA-ja dhe Kanadaja, u nënshkrua fundi zyrtar i Luftës së Ftohtë dhe i ndarjes së Evropës (Karta e Parisit).

²⁰ <http://www.bbc.co.uk/history/worldwars/coldwar/>

Punim Diplome

Një vit më vonë, më 11 korrik 1991, nënshkruhet në Pragë edhe suprimimi formal i Traktatit të Varshavës. Në të njëjtin vit, më 21 dhjetor shkatërrohet BRSS-ja.

BIBLOGRAFIA DHE REFERENCAT TJERA

Anton Bebler : Hyrje në integrimet evropiane, Prishtinë 2008

Bejtush Gashi , Pjeter Hidi : Konfliktet ndërkombëtare dhe ndëretnike , Prishtinë, 2008

Lidija Cehuliq: Euroatlantizmi , Prishtinë, 2006

Radovan Vukadinovic : Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe Lufta e Ftohtë deri te rendi global , Prishtinë, 2007

Ukshin Hoti : Lufta e Ftohte dhe Detanti , Prishtinë 1976

<http://www.bbc.co.uk/history/worldwars/coldwar/>

Baca, Ferit “Hartimi i një teme diplome “ ,Tiranë ,Globus R. 2010